



Empowered lives.
Resilient nations.

Programi dhe Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike

Transparenca dhe kriteret e përdorura gjatë zbatimit



Mars 2021

Mbështetur nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo



Sweden
Sverige



Empowered lives.
Resilient nations.

**Programi dhe Ligji për
Rimëkëmbje Ekonomike**
Transparenca dhe kriteret e
përdorura gjatë zbatimit

Mars 2021

— **Përmbajtja**

3 Përmbledhje ekzekutive

4 Hyrje

5 Zbatimi i Programit të
Rimëkëmbjes Ekonomike në 2020

6 Transparenca gjatë zbatimit
të masave të Programit të
Rimëkëmbjes Ekonomike

6 Kriteret e përdorura për
përzgjedhjen e përfituesve në
kuadër të masave të Programit të
Rimëkëmbjes Ekonomike

9 Masat nga Ligji për Rimëkëmbjen
Ekonomike

11 Përfundim

12 Aneks

Mbështetur nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo



Sweden
Sverige

Përmbledhje ekzekutive

Pandemia COVID-19 përveç se kishte ndikim negativ në aspektin shëndetësor dhe social, ajo ka goditur rëndë dhe ekonominë e Kosovës. Rënia reale e ekonomisë në vitin 2020 në Kosovë përlllogaritet të jetë 6.7% e Bruto Produktit Vendor (BPV). Për të amortizuar këtë rënie, pas Pakos Emergjente Fiskale, në gusht të vitit 2020, Qeveria e Kosovës kishte aprovuar edhe Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike për vitin 2020, në vlerë prej 365 milionë euro. Programi përbëhej nga 15 masa dhe disa nën-masa të cilat parashihnin mbështetje të sektorëve dhe qytetarëve të prekur nga pandemia COVID-19. Ngjashëm, në fund të vitit 2020, Kuvendi i Kosovës kishte aprovuar edhe Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike të propozuar nga qeveria, që parashihte masa shtesë në ndihmë të ekonomisë. Konkretisht, të dy këto iniciativa parashihnin ndihmesa të ndryshme për qytetarët dhe sektorin e shëndetësisë, arsimit, bizneset dhe ndërmarrjet publike.

Në kuadër të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, gjatë vitit 2020 janë alokuar vetëm 250 nga 365 milionë euro të planifikuara. Rreth 143 milionë euro ishin ndarë si ndihmë për sektorin privat, 24 milionë euro për sektorin publik, 12 milionë euro për çështje sociale, rreth 10 milionë euro arsim dhe 2.5 milionë euro për kulturë, rini dhe sport. Ndërkaq, në fund të dhjetorit, me miratimin e Ligjit të Rimëkëmbjes Ekonomike, qeveria kishte ndarë 21.5 milionë euro për Fondin për Garanci Kreditorë (FGK) për garantim të kredive të reja të bizneseve. Po ashtu, përmes tërheqjes së kursimeve prej 10% nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti) kanë përfituar qytetarët me kursime nën 10,000 euro, pasi që atyre qeveria do tu rimbursojë kursimet e tërhequra. Ndërsa, nga 1 janari i vitit 2021 janë ndihmuar edhe bizneset nga sektori i mineraleve dhe minierave të cilët nuk do të paguajnë rentën minerare për pesë muaj, dhe qytetarët e bizneset duke paguar fatura më të ulëta të energjisë elektrike për tre muajt e parë të vitit 2021.

Të gjeturat e këtij raporti tregojnë se nga shpërndarja e mjeteve në kuadër të rimëkëmbjes ekonomike, bizneset kanë përfituar në mënyrë proporcionale dhe jo sipas ndikimit të pandemisë COVID-19 në aktivitetin e tyre. Këtu përfshihet masa për subvencionim të pagave në sektorin privat prej 60 milionë euro, ndonëse disa sektorë ekonomikë, sikurse ai i informimit, shëndetësisë dhe industrisë përpunuese, kishin pasur rritje reale gjatë pandemisë deri në 30%. Për disa nga masat tjera, institucionet implementuese kanë zgjedhur në mënyrë arbitrare, pa prezantuar ndonjë analizë, që të alokojnë të gjithë fondin e masës për vetëm një grup të qytetarëve apo bizneseve. Sikurse vendimi i Zyrës për Barazi Gjinore në kuadër të Qeverisë së Kosovës për alokimin e gjithë fondit të masës për përmirësimin e gruas në shoqëri për kopshtet e fëmijëve. Po ashtu, përmes Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike janë liruar nga renta minerare për pesë muaj të gjithë operatorët në këtë sektor, ndonëse të dhënat nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, të shprehura përmes inkasimit të të hyrave nga renta minerare, tregojnë për mos rënie të aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2020 në këtë sektor. E vetëm kjo politikë pritet t'i kushtojë buxhetit shtetëror rreth 15 milionë euro. Po ashtu, qeveria ka vendosur për subvencionim të tarifës të energjisë elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtrishme të Energjisë për tre muaj për të gjithë qytetarët dhe bizneset. Kjo përkundër që një numër i madh i qytetarëve kanë punuar në vazhdimësi gjatë pandemisë, sikurse mbi 80 mijë punonjës në sektorin publik, një pjesë e madhe e shoqërisë civile, sektorit privat etj. Ngjashëm, edhe vendimi për rimbursimin e 10% të kursimeve të tërhequra nga Trusti Pensional i Kosovës (Trusti) për qytetarët me kursime nën 10,000 euro,

* Ky raport analizon zhvillimin e ngjarjeve dhe të dhënat e qasshme deri në shkurt 2021.

paraqet diskriminim ndaj të punësuarve më me pak përvojë, atyre me paga më të ulëta, të punësuarve në sektorin jo formal dhe grave.

Në mënyrë që ndikimi i ndihmës së shpërndarë të jetë më i madh, shpërndarja e mjeteve duhet të jetë transparente dhe të orientohet vetëm tek subjektet të cilat kanë nevojë. Veçanërisht, përpilimi i kriterëve të duhura mbetet elementi kyç për një alokim efikas të fondeve të qeverisë. Gjetjet e këtij raporti tregojnë se institucionet relevante për zbatim të këtyre masave nuk kanë qenë transparente gjatë shpërndarjes së mjeteve, ku për shumë masa nuk dihen përfituesit, ndërsa në disa tjera nuk dihet shuma e ndarë. Po ashtu, dizajnimi i kriterëve për zbatim të këtyre masave ishte i tillë që në shumicën e tyre nuk ishte futur si kriter ndikimi nga pandemia për të përfituar nga ndihma financiare. Andaj, ndihma e shpërndarë përmes shumicës së masave ishte proporcionale për të gjithë përfituesit dhe nuk klasifikonte për përfitim vetëm bizneset dhe qytetarët e goditur nga pandemia.

Hyrje

Fillimi i pandemisë COVID-19 gjatë vitit 2020 detyroi institucionet përgjegjëse që të marrin vendime për ndalimin e lëvizjes së qytetarëve dhe operimin e shumë ndërmarrjeve ekonomike. Kjo kishte shkaktuar rënie të aktivitetit në shumë sektorë ekonomikë¹ dhe dyfishim të punëkërkesve të regjistruar brenda vitit; në rreth 200,000 mijë të tillë.² Si rrjedhojë, gjatë vitit 2020 kishte rënie ekonomike reale prej 6.7% të BPV.³ Në tentim për të normalizuar këtë goditje për ekonominë, Qeveria e Kosovës, kishte miratuar Programin për Rimëkëmbje Ekonomike në vlerë prej 365 milionë eurove.⁴ Mirëpo, deri në fund të vitit 2020, ky program ishte realizuar vetëm në shkallën prej 68.5%. Janë gjithsej 19 vendime⁵ të qeverisë të cilat parashohin alokim të mjeteve për implementimin e një numri të masave dhe nën-masave të këtij programi, ku vlera e ndarë deri në dhjetor të vitit 2020 është rreth 250 nga 365 milionë euro sa ishte fondi.⁶

Krahas këtij programi, qeveria kishte propozuar edhe Ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike i cili u miratua në Kuvendin e Kosovës vetëm në dhjetor të vitit 2020.⁷ Ky ligj parasheh një sërë masash në ndihmesë të ekonomisë, disa nga të cilat filluan së aplikuari qysh javën e parë pas miratimit të tij, meqë ishin bërë përgatitje të mëhershme, e disa nga do të zbatohen gjatë vitit 2021. Ndër masat që kishin filluar të zbatoheshin ishin ajo për tërheqjen e 10% të kursimeve nga Trusti, lirimi nga TVSH për prodhuesit e lëndës së parë, lirimi nga TVSH për furnizim më mallra për sektorin e gastronomisë, etj.

Ky raport analizon shpërndarjen e mjeteve në kuadër të këtyre masave, konkretisht nivelin e transparencës lidhur me përfituesit e ndihmës financiare dhe shumën e përfituar. Po ashtu, do të analizohen kriteret e përdorura nga institucionet gjatë ndarjes së mjeteve në funksion të asaj nëse ato targetojnë bizneset dhe qytetarët më të prekur nga pandemia.

1 Agjencia e Statistikave të Kosovës. Bruto Produkti Vendor TM3 2020. Burimi: <https://bit.ly/3rZkl4l>

2 Të dhëna të pranuar nga Agjencia e Punësimit të Kosovës gjatë muajit tetor 2020.

3 Ministria e Financave. Buxheti 2021: Perspektiva Makroekonomike. Burimi: <https://bit.ly/3toVgpX>

4 Qeveria e Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 23. Burimi: <https://bit.ly/33CIHg3>

5 Shuma e ndarë në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes është nxjerrë nga vendimet e qeverisë për alokim të mjeteve pasi që Departamenti i Thesarit në Ministri të Financave nuk na i ka dërguar të dhënat rreth realizimit të pagesave në kuadër të pakove fiskale.

6 Shih Aneksin.

7 Qeveria e Kosovës. Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike. Burimi: <http://bit.ly/3m1tsLX>

Zbatimi i Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike në 2020


Nga masat e ekzekutuara gjatë vitit 2020 të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, vlerë më të madhe zënë ndihmesa për sektorin privat, konkretisht implementimi i plotë i masës së pakos emergjente për mbulimin e dy pagave nga 170 euro për punonjësit e sektorit privat të prekur nga pandemia, si dhe ndarja edhe e një page prej 239 euro për punonjësit e të gjitha bizneseve aktive. Duhet të sqarohet se Programi për Rimëkëmbjen Ekonomike ka përfshirë brenda saj edhe masat e porealizuara dhe disa detyrime tjera nga Pakoja Emergjente Fiskale, dhe të njëjtat zënë rreth një të tretën e programit të rimëkëmbjes. Po ashtu, është ndarë shuma prej 21.5 milionë eurove për Fondin për Garanci Kreditore për rritjen e mbulueshmërisë së kredive të reja, si dhe janë ndarë 12 milionë euro për dyfishim të pagesave direkte dhe subvencioneve për fermerët.

Si kategori e dytë me më shumë buxhet të ndarë gjatë vitit 2020 në kuadër të këtij programi ishte sektori publik, ku bëjnë pjesë kryesisht shtesat për stafin mjekësor dhe atë të policisë, të cilët ishin më të ekspozuar ndaj virusit COVID-19. Në këtë kategori hyn edhe mbështetja për ndërmarrjet publike ku ndihmën më të madhe e kishte përfituar Trepça me mbi 1.1 milionë euro.

Kategoria e tretë, kryesisht dominohet nga dyfishimi i asistencës sociale për disa muaj të vitit 2020 dhe ndihmesa për shoqatat e familjeve të dëshmorëve. Ndërsa kemi edhe 3 milionë euro të ndara për mbulimin e kostos së primit të policisë së sigurimit në kufi për diasporën. Për këtë masë mund të mos jetë ekzekutuar buxheti tërësisht mirëpo meqë fondi është ndarë, mjetet mund të alokohen përgjatë muajve.

Rreth 10 milionë euro janë ndarë për mbarëvajtjen e procesit mësimor gjatë pandemisë, ndërsa 2.5 milionë euro tjera për sektorin e kulturës dhe rinisë, në të cilin program parashihet subvencionim i artistëve të prekur nga pandemia dhe ofrimi i mundësisë për punë praktike për një numër të konsiderueshëm të të rinjëve.

Figura 1. Ndarja e mjeteve nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2020 sipas sektorëve



Transparenca gjatë zbatimit të masave të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike

Gjatë zbatimit të masave më lartë dhe gjithë masave tjera të zbatuara gjatë vitit 2020, të cilat janë të listuara në ankesin 1, vërehet qasje e ndryshme e institucioneve lidhur me ofrimin e transparencës dhe aplikimin e kriterëve gjatë implementimit të masave.

Tek masat dhe nën-masat e zbatuara, në shumicën e tyre ku transparenca ka qenë e nevojshme, sidomos tek ato me buxhet të lartë për ndihmesë të sektorit privat, institucionet nuk kanë publikuar informata rreth ndarjes së mjeteve. Në këtë pikë, qasja e institucioneve mund të kategorizohet në dy grupe. Fillimisht, kemi grupin e institucioneve të thirrura për zbatimin e një sërë masash të cilat nuk kanë publikuar listat e plota të përfituesve të ndihmave dhe as shumën e ndarë për secilin përfitues. Konkretisht, Ministria e Zhvillimit Rajonal ka ndarë 2 milionë euro për 156 biznese, mirëpo nuk ka publikuar listat me subjektet fituese dhe shumën e ndarë për secilën nga to.⁸ Ngjashëm, Zyra për Çështje të Komuniteteve e cila shumën prej 1 milion eurove nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike ka synuar ta ndajë për tri kategori, nuk ka publikuar listat për secilën nga grupet përfituese, por vetëm pjesërisht, dhe as shumën e ndarë për përfituesit.

Ndërsa, në grupin tjetër kemi institucione të cilat kanë publikuar njërin nga këto, të dhëna lidhur me përfituesit ose shumën e ndihmës së dhënë. Tek ndarja e 60 milionë eurove për bizneset në formë të subvencionimit të pagave nga Ministria e Financave, nuk janë publikuar listat e bizneseve përfituese, mirëpo është bërë e ditur se ndihma do të jetë 239 euro për secilin të punësuar. Ngjashëm edhe tek masa për shpërndarjen e 10 milionë eurove tek 38 komunat, nuk është publikuar lista që tregon shumën e ndarë për secilën komunë. Po ashtu, tek masat e ekzekutuara për përmirësimin e pozitës së gruas, artistëve dhe komuniteteve jo-shumicë të prekura nga pandemia, ndonëse janë publikuar listat e përfituesve nuk është publikuar shumata e ndarë për secilin përfitues.


Kriteret e përdorura për përzgjedhjen e përfituesve në kuadër të masave të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike

Tek pjesa e kriterëve, si pjesa më e rëndësishme për alokim më efikas të mjeteve dhe ndihmesë së bizneseve më të prekur nga pandemia, të gjeturat tregojnë se në shumicën prej masave, kualifikimi për të përfituar nuk është kushtëzuar në dëmin e pësuar nga pandemia COVID-19. Sikurse në rastin e shpërndarjes së 60 milionë eurove për paga në sektorin privat, ashtu edhe tek subvencionet dhe pagesat direkte në bujqësi, mbështetja e bizneseve përmes granteve, mbështetja financiare e kopshteve, nuk theksohet nëse subjektet përfituese apo ata si individë duhet të dëshmojnë se operimi i biznesit të tyre dhe puna e tyre po rrezikohet nga pandemia. Vetëm tek mbështetja e bizneseve përmes masës për komunitetet jo-shumicë caktohet si kriter ndikimi i pandemisë COVID-19 në operim të tyre. Ngjashëm, edhe tek masa për ndarjen e 10 milionë eurove për komunat theksohet si një ndër kriteret për përfitim izolimi i detyruar gjatë pandemisë. Por, edhe në këto dy raste, nuk dihet se sa janë apikuar këto kriterë, meqë institucionet implementuese të këtyre masave nuk kanë publikuar të dhëna lidhur me ndarjen e mjeteve.

⁸ Janë publikuar vetëm disa lista të subjekteve që kualifikohen në fazën e dytë ku nuk tregohet emri i biznesit, shumata etj, por vetëm të dhëna tjera rreth qytetit apo numrit të protokollit.

Si rezultat i kësaj qasjeje, mbështetja e bizneseve dhe individëve ka mund të rezultojë me shpërndarje të pa justifikueshme të mjeteve, meqë jo të gjitha bizneset, kulturat bujqësore etj., mund të jenë ndikuar negativisht nga pandemia. Ngjashëm, shpërndarja proporcionale e mbështetjes financiare e minimizon efektin e dëshiruar meqë mund të jetë e pamjaftueshme për subjektet e goditura rëndë nga pandemia, dhe e humb qëllimin në rast të shpërndarjes së saj tek disa veprimtari të cilat janë ndikuar pak nga pandemia COVID-19. Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) deri në trejumorin e tretë të vitit 2020, tregojnë se industria përpunuese, informacionit dhe patundshmërive kishin pasur rritje reale të vazhdueshme në secilin tremujor krahasuar me vitin 2019. Ngjashëm edhe sektori i shëndetësisë, ku bëjnë pjesë spitalet private, farmacitë, dhe laboratorët privat, përveç një rënie të lehtë në tremujorin e parë të vitit 2020 krahasuar me vitin 2019 (1.9%), në dy tremujorët vijues kishin rritje të theksuar prej 23% dhe 16%. Përkundër gjithë kësaj, të gjitha bizneseve në këta sektorë u është ndarë mbështetje financiare përmes masës për subvencionimin e pagave që kishte vlerë prej 60 milionë euro.⁹

Figura 2. Rritja reale e sektorëve gjatë periudhës TM1-TM3 2020 krahasuar me 2019







































































































Burimi: ASK

Ngjashëm, disa nga institucionet përgjegjëse për implementim të masave kanë targetuar vetëm një grup të bizneseve që mund të përfitojnë, pa paraqitur ndonjë analizë që tregon ndikimin më të madh të pandemisë tek ta se tek grupet tjera. Njëkohësisht, në rast se institucioni në fjalë ka paraparë ndarje të buxhetit për më shumë se një grup, nuk është arsyetuar apo treguar mënyra e ndarjes së buxhetit mes grupeve. Tek implementimi i masës për përmirësimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe ekonomi me vlerë prej 1 milion euro, të gjitha mjetet janë destinuar vetëm për bizneset e kopshteve të fëmijëve. Pra janë lënë anash bizneset e udhëhequra nga gratë, apo që punësojnë kryesisht gra, nga sektorët tjerë ekonomikë. Po ashtu, tek implementimi i masës prej 1 milion euro në ndihmesë të komuniteteve jo-shumicë, nuk argumentohet se pse duhet të ndahet buxheti për tre grupet e të zgjedhura. Për më shumë, tek grupi i parë ku hyn dërgimi i pakove ushqimore për personat në nevojë, nuk paraqitet asnjë kriter për përzgjedhje, për çka zyrës implementuese të kësaj mase i jepet diskrecion i madh në përzgjedhje të familjeve që do të ndihmohen.

⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Bruto Produkti Vendor TM3 2020. Burimi: <https://bit.ly/3rZkl4l>

Tabela 1. Transparenca dhe kriteret e përdorura gjatë zbatimit të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, 2020

	 Po	 Jo	 Pjesërisht	 Nuk aplikohet	A janë publikuar thirrjet dhe kriteret për përfitim nga këto masa?	A janë publikuar listat e perfituesve?	A ka qenë kualifikimi për përfitim të ndihmës I kushtëzuar në dëmin nga COVID-19?	A janë shpërndarë mjetet në proporcion me dëmin e shkaktuar nga COVID-19?	A tregohet shuma e ndarë?	Kriteret webfaqe
Subvencionim i pagës për punëtorët në biznese të prekur nga pandemia për muajin Mars dhe Prill (170 Euro) në vlerë prej 47,300,000 €										
Mbështetje financiare për Projektet dhe iniciativat që synojnë përmirsimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe ekonomi										
Subvencionet dhe pagesat direkte në bujqësi										
Mbështetje për programet ekzistuese dhe të reja të cilat lidhen me zhvillimin rajonal të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal										
Përmirësimi i jetës së komuniteteve jo shumicë dhe rimëkëmbja e tyre ekonomike										
Kulturë, rini, sport										
Shtesa për mjekët, infermierët (shtator 2020 - dhjetor 2020) dhe stafin mbështetës (korrik 2020 - dhjetor 2020)										
Subvencionim i ndërmarrjes publike "Trepça"										
Subvencionimi i pagave për të gjitha bizneset në sektorin privat										
Subvencionim për ndërmarrjet publike										
Shtesa për policë										
Mbështetje për komunat e Kosovës për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID 19, në vlerë prej dhjetë milionë euro (10,000,000 euro)										

Masat nga Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike

Me miratimin e Ligjit të Rimëkëmbjes Ekonomike gjatë dhjetorit 2020¹⁰, ka filluar edhe zbatimi i disa masave tjera që lidhen me rimëkëmbjen ekonomike.¹¹ Në dhjetor kishte gjetur zbatim politika e qeverisë për lejimin e qytetarëve për të tërhequr 10% të kursimeve të tyre nga Trusti. Kjo politikë, veçanërisht pjesa ku qeveria merr përsipër rimbursimin e llogarive, ku si kriter caktohet që shuma maksimale e tërhequr të jetë deri në 999 euro, paraqet diskriminim ndaj disa grupeve sikurse të punësuarve më me pak përvojë dhe atyre me paga më të ulëta. Po ashtu, ndaj të punësuarve në sektorin jo formal dhe grave, si më me pak mundësi në tregun e punës dhe me vetëm 33% pjesëmarrje si kontributpaguese në Trust.¹² Rrjedhimisht, nuk përfitojnë personat në pozitë më të palakmueshme në tregun e punës, që pandemia i ka vënë në pozitë edhe më të pafavorshme, por personat më të ardhura më të larta. Efektet e kësaj politike në ekonomi mund të reflektohen më shumë gjatë vitit 2021 edhe pse siç tregonin të dhënat rreth kontributpaguesve, se rreth 20% e tyre mund të tërhiqnin mbi 72% të fondit prej 200 milionë eurove të paraparë për t'u injektuar në ekonomi, gjasat që mjetet të mos shpenzoheshin nga një numër i madh i kontributdhënësve por të kurseheshin ishin të mëdha.¹³ Për çka, në rritjen prej 11% të depozitave në banka në fund të vitit 2020, mbi 40% përlllogaritet të ketë ndikuar tërheqja e kursimeve të Trustit, të cilat janë deponuar në llogari private por nuk janë shpenzuar menjëherë.¹⁴

Në fund të muajit dhjetor të vitit 2020, Qeveria e Kosovës kishte ndarë 21.5 milionë euro për Fondin për Garanci Kreditore (FGK) në mënyrë që e njëjta të rrisë numrin dhe shkallën e mbulimit të kredive. Meqë kjo masë është miratuar vonë, efekti i saj pritet të vërehet kryesisht gjatë vitit 2021. Sipas të dhënave të FGK, në kuadër të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, prej dhjetor 2020 deri në shkurt të vitit 2021, ky institucion ka garantuar kredi me vlerë rreth 6.8 milionë euro përmes pesë dritareve të hapura, ku shuma e garantuar ishte rreth 5 milionë euro apo rreth 73%. Numri dhe vlera më e madhe e kredive të garantuara është për sektorin e tregtisë, me 57 kredi të garantuara me vlerë mesatare të kredisë mbi 73 mijë euro. Më pas radhitet sektori i shërbimeve me numër më të lartë të kredive të garantuara (23). Po ashtu, FGK ka krijuar dhe një dritare vetëm për gratë në biznes, që është një hap shumë i qëlluar marrë parasysh qasjen e kufizuar të grave në financa. Përmes kësaj dritareje janë garantuar 22 kredi. Pjesa tjetër e garancioneve të kredive është bërë për bizneset në sektorin e prodhimit, ku vlera mesatare e kredisë së garantuar ishte rreth 44 mijë euro kurse numri i kredive të garantuara ishte 17. Ndërsa e fundit mbetet kategoria e kredive për buqësi me vetëm 11 kredi të garantuara.¹⁵

10 Qeveria e Kosovës. Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike. Burimi: <http://bit.ly/3nitsLX>

11 Masat në kuadër të ligjit për të cilat nuk është ndarë buxhet apo nuk ka filluar implementimi i tyre nuk trajtohen në këtë raport.


12 Instituti GAP. Dilema 10% përfitimet dhe dëmet nga tërheqja e parakohshme e kursimeve pensionale. Burimi: <https://bit.ly/3lCN6rl>

13 Insituti GAP. Burimi: <http://bit.ly/3r7cDKh>

14 Fondi Monetar Ndërkombëtar. Republika e Kosovës: 2020 Konsultimi i Artikullit IV. Burimi: <https://bit.ly/3oFJeh>

15 Fondi për Garanci Kreditore. Pako e Rimëkëmbjes Ekonomike. Burimi: <https://bit.ly/3sdWsw3>

Figura 3. Garantimi i kredive nga FGK në kuadër të rimëkëmbjes ekonomike, shkurt 2021



Një nen tjetër i Ligjit parasheh lirim nga pagesa e rentës minerare për bizneset që operojnë në këtë fushë. Por, kjo industri nuk kishte ndalë veprimtarinë e saj asnjëherë gjatë masave kufizuese për shkak të pandemisë COVID-19. Sipas të dhënave të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, të hyrat nga renta minerare gjatë vitit 2020¹⁶ ishin 29.7 milionë euro apo vetëm 539 mijë euro (1.8%) më të ulëta se në vitin 2019.¹⁷ Kjo tregon se përfitimi nga lirimi prej pagesës së rentës minerare nuk kushtëzohet në dëmin e shkaktuar nga pandemia ndaj përfituesve, dhe marrë parasysh këtë performancë të sektorit është shumë e vështirë të argumentohet në favor të këtij vendimi që buxhetit të shtetit pritet t'i kushtojë rreth 15 milionë euro.¹⁸

Figura 4. Të hyrat nga renta minerare të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale gjatë periudhës 2019-2020



Burimi: Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

¹⁶ Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale 2020. Burimi: <https://bit.ly/3bXiRYC>

¹⁷ Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale 2019. Burimi: <https://bit.ly/38V5eHL>

¹⁸ Koha.net. Burimi: <https://bit.ly/38QVr5J>

Ngjashëm, në një nen tjetër të këtij Ligji, qeveria merr përsipër të subvencionojë të gjithë tarifën e Burimeve të Ripërtrishme të Energjisë Elektrike për të gjithë qytetarët dhe bizneset në Kosovë për disa muaj.¹⁹ Pra, qeveria ka vendosur të zbatojë një politikë të tillë gjithëpërfshirëse përkundër që qytetarët të cilët punojnë në sektorin publik, mbi 80 mijë, një pjesë e madhe e shoqërisë civile, sektorit privat etj., kanë marrë paga të rregullta gjatë tërë pandemisë. Pra, edhe në këtë rast, nuk është përdorë si kriter ndikimi negativ nga pandemia COVID-19 në të ardhurat e bizneseve apo ekonomive familjare.

Po ashtu, ligji në fjalë parasheh edhe disa lirime tatimore. Ai u jep përparësi ofruesve të shërbimeve dhe prodhuesve vendor krahas ofertuesve të huaj në procedurat e përzgjedhjes së fituesve gjatë procedurave të prokurimit publik. Përparësia e dhënë është në aspektin se oferta e prodhuesit vendor përzgjedhet edhe nëse gjatë vlerësimit kanë marrë deri në 10 pikë më pak se ofertuesi i huaj ose çmimi i ofruar nga prodhuesi vendor është deri në 15% më e lartë se e ofertuesit më të mirë të huaj. Si dhe, prodhuesit vendor të lëndës së parë lirohen nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH). Ngjashëm lirim nga TVSH për mallin e blerë (furnizim) do të kenë dhe hotelet, restorantet dhe shërbimet e ushqimit. Kurse të gjithë tatimpaguesit mund të përfitojnë nga lirimi prej interesit për borxhin e papaguar për vitin 2020 ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) në rast se e shlyejnë borxhin bazë.²⁰

Përfundim

Gjetjet e këtij raporti tregojnë për jo-transparencë rreth shpenzimit të parasë publike dhe mos aplikim të kriterëve adekuate për alokim efikas të mjeteve të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike. Shumë nga institucionet nuk kanë publikuar të dhëna lidhur me mjetet e ndara për përfituesit në kuadër të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike. Ndërsa, thujtë në të gjitha masat, sidomos ato me buxhet tejet të lartë, është neglizhuar tërësisht përfshirja e ndikimit nga pandemia COVID-19 si kriter për të përfituar nga fondet e ndara. Andaj, edhe ndikimi i Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike duhet të jetë i kufizuar.

Mbetet e rëndësishme që:

- Të bëhet një auditim i mjeteve të shpenzuara në kuadër të pakove fiskale dhe masave nga Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për të vlerësuar shpërndarjen e mjeteve, kriteret e vendosura për përzgjedhje të përfituesve, dhe arsyeshmërinë e dhënë në përzgjedhjen e përfituesve;
- Të rritet transparenca gjatë zbatimit të masave të reja në kuadër të pakove fiskale në ndihmesë të ekonomisë;
- Secila masë e re që synon të ndihmojë bizneset dhe qytetarët e prekur nga pandemia, përveç rasteve sociale, grupeve të diskriminuara dhe sektorëve apo grupeve me interes për shoqërinë (studentët e IT-së, sektorin e turizmit, etj.) të ketë si kriter kryesor dëmin e pësuar nga pandemia;
- Të bëhet koordinim më i mirë i institucioneve në mënyrë që zbatimi i pakove fiskale të jetë më i shpejtë, dhe si rrjedhojë edhe efekti në ekonomi të jetë më i madh.

¹⁹ Në ligj ceket që subvencionimi do të bëhet për pesë muaj mirëpo me vendimin 3/69 gjatë vitit 2021 është vendosur të përgjysmohet shumta e ndarë, me të cilën arrihet të mbulohet vetëm kosto për tre muaj.

²⁰ Ndërsa masat tjera të Ligjit për rimëkëmbje ekonomike për subvencionim të pagave, për të cilat nuk janë ndarë mjete në ligjin e buxhetit 2021, dhe që rrjedhimisht nuk pritet të realizohen gjatë vitit 2021 nuk janë analizuar në këtë dokument.

Aneks

Tabela 2. Ndarja e mjeteve në kuadër të Programit të Rimëkëmbjes për vitin 2020

Vendimi	Për masën	Shuma €	Përshkrimi
Nr. 01/27	11	9,926,959	Aprovimi i master planit për zhvillimin e mësimit në kushte pandemie 2020-2021
1/23	3A	47,000,000	Subvencionim i pagës për punëtorët në biznese të prekur nga pandemia për muajin Mars dhe Prill (170 Euro), në vlerë prej dyzet e shtatë milionë e treqind mijë euro (47,300,000.00 €)
1/23	13	3,000,000	Mbështetje financiare për bashkatdhetarët duke mbuluar koston e primit të policës së sigurimit, në vlerë prej tre milionë euro (3,000,000.00 €);
Nr. 02/33 por duhet bazuar ne vendimin 10/33 ndonese arsyetimi i referohet vend. 1/23	10	1,000,000	Mbështetje financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë përmirsimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe ekonomi
Nr. 03/33	4A nga Pako por 1.3 nga vendimi i ri mandej	12,000,000	Subvencione dhe pagesa direkte në bujqësi
Nr. 13/33	8	2,000,000	Mbështetje për programet ekzistuese dhe të reja të cilat lidhen me zhvillimin rajonal të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal
Nr.06/34	9	1,000,000	Përmirësimi i jetës së komuniteteve jo shumicë dhe rimëkëmbja e tyre ekonomike
Nr.10/34		13,000,000	Për zbatimin e masave për rimëkëmbje ekonomike - kategoria subvencione dhe transfere
Nr. 10/33	1.6	2,500,000	Kulturë, rini, sport
Nr.18/38		8,000,000	Shtesa për mjekët, infermierët (shtator 2020 - dhjetor 2020) dhe stafin mbështetës (korrik 2020 - dhjetor 2020)
Nr.01/44	Masa 6C	1,000,000	Subvencionim i ndërmarrjes publike "Trepça"
	Masa 1.1	60,000,000	Subvencionim i pagave për sektorin privat
	Masa 1.2	7,500,000	Dyfishim i asistencës sociale tetor-dhjetor
Nr.21/48		203,000	Për familjet e dëshmorëve
Nr.07/50	1.1 dhe 1.15	28,176,480.50	Rimbursim i linjave buxhetore
Nr.08/50	1.6 dhe 1.7	17,034,744.08	Rimbursim i linjave buxhetore
Nr.14/50		1,000,000	Subvencionim për ndërmarrjet publike
Nr.02/52	Masa 15	1,598,100	Shtesa për policë
Nr.06/52		21,510,000	Fondi per Garanci Kreditore
Nr. 11/30	12	10,000,000	Mbështetje për komunat e Kosovës për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID 19, në vlerë prej dhjetë milionë euro (10,000,000 euro)
02/32	15	2,396,023	Sipas kërkesës së Ministrisë së Punëve të Brendshme/ Policisë së Kosovës, për angazhimin e shtuar dhe punë me orar të zgjatur në terren të zyrtarëve policorë aktiv në terren dhe të ekspozuar drejtpërdrejtë ndaj pandemisë COVID-19.


Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4,
10000 Prishtine

+381 38 609 339


info@institutigap.org



Instituti GAP përkrahët nga:



Ky projekt mbështetet nga:





Empowered lives.
Resilient nations.

Mbështetur nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo



Sweden
Sverige

**Programi dhe Ligji për
Rimëkëmbje Ekonomike:**
Transparenca dhe kriteret e
përdorura gjatë zbatimit